



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT

OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN / GILAN BELEDIYESI



KONTRATA PUBLIKE KORNIZË
651-25-725-2-1-1/C752

KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; Dhe

EL-BAU SH.P.K., LIMON STANECI P.N., GJILAN, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

"Mirëmbajtja Verore e rrugëve në Komunën e Gjilanit" me numër identifikues: 651-25-725-2-1-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

LOT 1 "Mirëmbajtja Verore e rrugëve në Komunën e Gjilanit" - sipas sasive të përshkruara në aneksin nr. 1 të dosjes së tenderit si dhe Listës së përshkrimit të çmimeve – Paramasës dhe parallogarisë.

Nr.	Grupi
Lot 1	Mirëmbajtja verore rrugëve në Komunën e Gjilanit Zona Veri-Perëndim në qytet

Përdorimi i kësaj kontrate publike kornizë është i detyrueshëm për të gjithë Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasinë e tyre përkatëse.

1.3 Sasinë e vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i(të) detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës ndërsa afati i përfundimit është jo më gjatë se 36 muaj nga data e Fletë Porosis nga Menaxheri i Kontratës.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë jo më gjatë **5 ditë** nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë : **Në Komunën e Gjilanit**

Neni 3 Çmimi

3.1 Kjo Kontratë Kornizë është e lidhur me çmime për Njësi dhe do të realizohet deri në vlerën e parashikuar . Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve e cila do të jetë pjesë përbërse e kësaj kontrate .

Vlera e parashikuar e kontates eshte 1,000,000.00€

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësisve do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve); **04.03.2025**

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.





5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shënohen në

përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Alban Hyseni	Emri:	Kujtim Bajrami
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ	Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	23.12.2025
Vula:		Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Fatlum Pireva
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	23.12.2025
Vula:	

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mb KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <i>pasi qe te nenshkruhet Kontratat</i>
Siguria e ekzekutimit	14.1	<i>Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10 % e vlerës e parashikuar të kontratës për kohëzgjatjen e periudhës prej 1130 diteve nga data e nënshkrimit të kontratës.</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo

		ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e pranimi të kërkesës së Menaxherit të kontratës.
Fillimi i punëve		Data e fillimit do të jetë 15 dite pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë. <i>Menaxheri i Projektit është i obliguar që mbrenda 5 dite pas pranimi të kopjes së nënshkruar të kontratës të hartoj planin e menaxhimit të kontratës, duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP C01-Plani për menaxhimin e kontratave</i>
Regjistri i punës	15.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit në baza ditore! Libri ndërtimor dhe Ditari ndërtimor do të mbahen në vendndërtim gjatë tërë kohës së ekzekutimit të punimeve nga fillimi deri në përfundimin e punimeve dhe deri në lëshimin e Certifikatës së Pranimi të Përkohshëm të Punëve (dhe të lëshohet Certifikata e Përdorimit). Udhëheqësi i vendndërtimit duhet të jetë prezent në vendndërtim me orarë të plotë të punës nga dita e parë e fillimit të punëve deri në përfundimin e tyre gjatë tërë kohës së implementimit të kontratës për organizimin dhe mbikëqyrjen e punimeve në vendndërtim, konform dokumentacionit ndërtimor dhe rregulloreve dhe standardeve teknike të ndërtimit. Inxhinierët përgjegjës i fazës së ndërtimit duhet të jenë prezent në vendndërtim me orarë të plotë gjatë tërë kohës sa ekzekutohen punime nga fusha përkatëse e tyre inxhinierike për të kontrolluar, verifikuar, sasinë dhe cilësinë e materialeve dhe punimeve dhe për të verifikuar zbatimin e normave dhe standardeve të ndërtimit për fazën e tij. Kontraktori: <ul style="list-style-type: none"> • është i detyruar të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë në vendet e punës, me qëllim të parandalimit të rrezikut, përfshirë dhe ekspozimin e të punësuarve nga elementet e dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë në punë gjatë procesit të punës. • Të pajisë të punësuarit, në mënyrë të detyrueshme,

		<p>me pajisje mbrojtëse individuale</p> <ul style="list-style-type: none"> • duhet të harton një plan për evakuimin dhe shpëtimin në situata emergjente, për të cilin i informon dhe ua bën të ditur të gjithë të punësuarve.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: <i>[shëno]</i> Periudha e përgjegjësisë së Defekteve është <i>[shëno datën]</i>
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet me vendim të veçant nga ZKA.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 1 vit pas kryerjes së punëve dhe pranimit të përkohshëm.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company I.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 147315

Për KOMUNA E GJILANIT

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të EL-BAU SH.P.K.

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Mirëmbajtja Verore e rrugëve ne Komunën e Gjilanit; LOT 1 Mirëmbajtja verore rrugëve në Komunën e Gjilanit Zona Veri-Perëndim në qytet**
Nr. prokurimit: 651-25-725-2-1-1

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci,
Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **100,000.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmiave të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **100,000.00€** siç është lartëcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 1130 ditë kalendarike prej **23.12.2025** deri më **26.01.2029**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe rrejetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve,

Data lëshimit: 23.12.2025

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.

"Mirëmbajtja Verore e rrugëve në Komunën e Gjilanit"

LOT 1 : Mirëmbajtja verore rrugëve në Komunën e Gjilanit Zona Veri-Perëndim në qytet

Parallogaria 1

Pika	Përshkrimi	Njesia	Sasia	Çmimi njësi me Tvsh	Çmimi total i 55% e pikëve për vlerësim
1.1	Riparimi i gropëzimeve,dhe shtresës qarkulluese në 7 cm trashësi nga asfalt-betoni AB-16(në këtë pozicion parashifet grynja me virgen e asfaltit egzistues, prerja në formë drejtëkëndëshe e gropëzimeve, lyerja me dy shtresa emulsion, furnizimi dhe asfaltimi).	m2	1.00	18.00 €	9.90 €
1.2	Shtrese e re qarkulluese me trashësi mesatare 4 cm,nga asfalt-betoni AB-11 me gerryerje nga fraksioni (me gerryerje ne çmim te perfshihet edhe largimi i materialit nga vendpunishja.	m2	1.00	14.00 €	7.70 €
1.3	Furnizimi, vendosja dhe ngjeshja e tamponit 0-61.5 mm. (moduli i ngjeshjes)-Mv=70MPa	m³	1.00	18.00 €	9.90 €
1.4	Furnizimi ,vendosja dhe ngjeshja e i tamponit 0-31.5 mm. (moduli i ngjeshjes)-Mv=100MPa	m³	1.00	18.00 €	9.90 €
1.5	Intervenimi ne trotualet ekzistues ne vendkalimet e kembesoreve, mvareshisht nga materiali i punuar, kubeza, asfalt me qelim te pershtatjes me nivelin e rruges. Sipas skices te ofruar DSHP)ne çmim te hyje demolimi, rregullimi dhe fuqia punetore.	m2	1.00	8.00 €	4.40 €
297,000.00 €					

Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë A



1.7	Rregullimi (nivelizimi) I kokes se pusetave (ngritja) te kanalizimit te ujerave te zeza sipas normave teknike per rugen me ngarkesa te renda. (Ne çmimin e betonit te hyje edhe armatura, kallapat dhe fuqia punetore)	cope	1.00	20.00 €	11.00 €
1.8	Rregullimi I pengesa (polic te shtrire) nga asfalti me dimensione D=(1.0x0.05xB)m, B-gjersia e ruges (shih shtojc)	m'	1.00	10.00 €	5.50 €
Gjithsej Paralogaria 1					59.40 €

Paralogaria 2

Pika	Përshkrimi	Njesia	Sasia	Çmimi njësi me Tvsh	Çmimi total I 15% e pikëve për vlerësim
2	Paralogaria 2- LARGIMI I UJRAVE ATMOSFERIKE				
2.1	Pastrimi dhe formësimi i kanaleve egzistuese	m'	1.00	3.00 €	0.45 €
2.2	Hapja e kanaleve të reja	m'	1.00	5.00 €	0.75 €
2.3	Gërmimi i dheut të kategorisë së III-të dhe të IV-të.	m³	1.00	7.00 €	1.05 €
2.4	Furnizimi dhe Vendosja e kapakëve të ujëmbledhësave për ngarkesa prej 25-40 tona sipas kërkesës	cope	1.00	80.00 €	12.00 €
2.5	Furnizimi dhe Vendosja e kapakëve të pusetave për ngarkesa prej 25-40 tona sipas kërkesës	cope	1.00	85.00 €	12.75 €
Gjithsej Paralogaria 2					27.00 €

Paralogaria 4

Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë B

150,000.00 €



Cmimi i pergjithshem i peshuar (oferta do te vlersohet ne baze te kesaj vlere). Kjo eshte vlera e cila duhet te shenohet ne Formularin e ofertes dhe do te lexohet gjat hapjes publike -F.

130.40 €

100%



Vrejte: Ju lutem beni verifikimin e formulave te llogaritjes per tu siguruar se gjithcka eshte ne rregull!

<p>+383-(0)- 49 244 330  +383-(0)- 48 234 007  shpkelbau@gmail.com</p>	 ELBAU Për një rrugë më të mirë	<p> Rr. Limon Staneci 60000 Gjilan, Republika e Kosovës</p> 
KOMPANIA EL BAU SH.P.K.		

Kompania "EL BAU" Sh.p.k. me seli në Gjilan, e përfaqësuar nga drejtori Fatlum Pireva me nr. personal 1171777956, lëshon këtë:

A U T O R I Z I M

Me të cilin autorizohet **Xhemile Hajdari Ismajli** e lindur me **19.08.1993** në Gjilan, shtetase e Republikës së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit **1173899099** të lëshuar nga MPB, Republika e Kosovës, që në emër dhe llogari të kompanisë EL-BAU Sh.p.k. pranë Komunës së Prishtinës përkatësisht Zyrës së Prokurimit të nënshkruajë kontratën me titull:

'Mirëmbajtja Verore e rrugëve ne Komunën e Gjilanit; LOT 1 Mirëmbajtja verore rrugëve në Komunën e Gjilanit Zona Veri-Perëndim në qytet dhe Lot 2 Mirëmbajtja verore rrugëve në Komunën e Gjilanit Zona Jug -Lindje në qytet me nr te prokurimit: 651-25-725-2-1-1.

Si dhe të ndërmarrë edhe veprime të tjera të nevojshme sipas rregulloreve përkatëse apo ligjore lidhur me kontratën në fjalë.

Veprimet e mësipërme të kryera nga përfaqësuesja e autorizuar i konsideroj të drejta sikur të isha vet i pranishëm në kryerjen e tyre.

Gjilan, 23.12.2025

Dhënësi i Autorizimit:


 Kompania "EL-BAU" Sh.p.k.
 Drejtor
 Z. Fatlum Pireva



